

**AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE « TRAKOS » SH.P.K**

Në Fier, sot më date 24/11/2022, janë të pranishëm shtetasit:

1. 1.ARBEN MUCOBEGA atësia Sadik i datëlindjes 23.06.1973,lindur në Tepelene Shqipëri, dhe banuese ne Tirane Shqipëri, mbajtës i ID.H30623016O ;

2-LORANT STAMBOLLIU atësia Sokrat,datëlindjes 01.08.1989 lindur ne Libofshe , Shqipëri, dhe banuese në Tirane Shqipëri mbajtëse e ID .I90801023P;

të cilët, në cilësinë e "Ortakëve Themelues", redaktuan këtë Akt themelimi , nëpërmjet të cilit ata deklaruan se me vullnet të lire të plotë dhe iniciativën e lire private, mbështetur ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil, Ligjin 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Ligjin Nr. 131/ 2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (Q.K.B.)", si dhe ndryshimet përkatëse, Si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore e fuqi, krijojnë/themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**TRAKOS**"

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është" TRAKOS" SH.P.K

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**TRAKOS** " SH.P.K është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota.

Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë, me seli në Zhupan qyteti Fier , rruga "Nuredin Aliu", lagjia "Kadri Hoxha" Zhupan, nr. pasurise 574/22-ND.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra, përfaqësi, dege, filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën si vijon:

- Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndryshme metalike.
- Ndertim depozitash dhe konstruksione të ndryshme metalike.
- Ndertim tubacione metalike me dhe pa presion.
- Prodhim dhe tregtim i eneve me dhe pa presion, si dhe punime të ndryshme ndertimi.
- Import, eksport të materialeve të ndryshme .
- Projektim dhe ndertim objekte civile dhe industriale.
- Prodhim konstruksione metalike, prodhim makineri dhe pajisje, prodhim linja teknologjike të perpunimit të metaleve.

Neni 5

Kohëzgjata

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë i përbërë nga gjithsej 2 kuota.

Kapitali themeltar është nënshkruar dhe i ndarë nga 2 ortakët e shoqërisë si vijon:

1. **Arben Mucobega** zotërues i 1 kuote, që përbën 53% të kapitalit në vlerën 53.000 Lekë.
2. **Lorant Stambolliu** zotërues i 1 kuote, që përbën 47 % të kapitalit në vlerën 47.000 lekë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;

- trashëgimisë;
- dhurimit;

dh) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga transferimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

NENI 8 .Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 administrator.

Administrator I shoqërisë është zgjedhur Z.Lorant Stambolliu, **mbajtes I kartes se identitetit I90801023P**, I cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori shkarkohet me kërkesë të ortakut maxhoritar për shkelje të statutit të shoqërisë, shkelje të ligjit, prishje imazhi dhe mos plotësim të detyrave të caktuara .

Emertimi / shkarkimi I Administratorit behet nga asambleja e ortakeve.

NENI 9 ;

SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

9/1 Pasuria e shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës si dhe në institute të tjera private ekzistuese apo që do të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi
9/2 Masa e pasurisë që do të sigurohet si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga Administratori .

Neni 10

MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.
NENI 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi , u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKET

1.ARBEN MUCOBEGA




Arben Mucobega


2.LORANT STAMBOLLIU



Lorant Stambolliu



Lorant Stambolliu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SONILA A. XUKTHI



V2022052700148985939



DATE 24/11/2022
NR REP 2538

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 24/11/ 2022, para meje Notere SONILA A. XUKTHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, EMIN DURAKU, NR.52, NR.1, NR.4, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUER: Arben Muçobega, atësia Sadik, amësia Zengjine, shtetas Shqiptar, lindur në Kamçisht, Tepelenë dhe banues në TIRANË, me adresë Muharrem Butka; Nd. 5; H. 2; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 23/06/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035044594 dhe nr. personal H306230160.

NËNSHKRUER: Lorant Stambolliu, atësia Sokrat, amësia Myrvete, shtetas Shqiptar, lindur në Libofshë, Fier dhe banues në FIER, me adresë Dervish Hekali 01490056; Nd. 18; H. 3; Ap. 30; Fier; Fier; 9305; Fier, lindur më 01/08/1989, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037381457 dhe nr. personal I90801023P, .

Shtetasit e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë Trakos sh.p.k", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

SONILA A. XUKTHI